



Prishtinë, 24.09.2018
Kodi i ZRRE-së: V_1035_2018

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

bazuar në:

- Dispozitat e Neneve 9, 15 dhe 26 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë,
- Dispozitat e Nenit 16, Paragrafi 1.11 të Ligjit për Energjinë Elektrike,
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë,
- Dispozitat e Nenit 12 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmetimit, dhe
- Kërkesën e KOSTT SH.A të datës 17.11.2017 për shqyrtimin dhe aprovimin e dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2018 – 2027”

në seancën e mbajtur me datë 24.09.2018 nxori këtë:

V E N D I M

I. **Aprovohet dokumenti “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2018–2027” i KOSTT-it**

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 17.11.2017 ka pranuar kërkesën për komentim dhe aprovim të dokumentit “Plani Zhvillimor i Transmetimit 2018 – 2027” të KOSTT SH.A. ZRRE ka dhënë komentet e veta të cilat janë përfshirë në dokument, janë sqaruar apo janë marrë përgjigjet në lidhje me çështjet e ngritura. Në ndërkohë dokumenti ka qenë i publikuar në ueb faqen e ZRRE për diskutim publik.

Pas përfshirjes së komenteve të ZRRE-së, KOSTT ka dërguar dokumentin final për miratim në ZRRE.

ZRRE ka analizuar dokumentin dhe vlerëson se dokumenti përmbush kriteret e kërkuara, dhe se projektet e përfshira në dokument janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të transmetimit, kështu që Bordi i ZRRE-së **aprovon “Planin Zhvillimor të Transmetimit 2018 – 2027”**.



I. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

III Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Arsim Janova, u.d. kryesuesit

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KOSTT SH.A,
- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji